



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamenti i Auditimit të Aseteve të Qëndrueshme,**  
**Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtja e Mjedisit**

---

Nr. 1252/11 Prot.

Tiranë, më 30.04.2017

**V E N D I M**

**Nr. 42, Datë 30/04/2017**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t, TIRANA 2 “MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtorit Përgjithshëm në mbështetje të neneve 10, 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave /Ndërtimeve Informale, Tirana 2, për periudhën nga data 01.08.2014 deri në datë 31.12.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

Ti kërkohet Ministrisë Zhvillimit Urban ti propozojë Këshillit të Ministrave të ndryshojë nenin 46 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, duke përfshirë nenin 27, në të drejtat që i jepen Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Gjithashtu Ministria e Zhvillimit Urban ti propozojë Këshillit të Ministrave të ndryshojë pikën 5, të VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, sipas së cilës ... *“Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.*

*Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”, e cila bie në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9482, datë 03.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar.*

### Argumentimi

Ka mospërputhje mes zbatimit të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”.

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të legalizimit të objekteve/shtesave anësore dhe në lartësi pa leje, ka rezultuar se Drejtoritë e ALUIZNI-t, pasi kanë lëshuar lejet e legalizimit, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, kanë dërguar pranë Njësive të Qeverisjes Vendore vetëm shkresën me të dhënat për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë më parë konfirmimin e kësaj pagese, duke ju referuar VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 ku citohet se: *Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin: ..... pika “ç” –“**vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi**”*

Konkretisht nga auditimi i ushtruar në ALUIZNI Tirana nr. 2, **në 1660 raste** në kualifikimin e objekteve informale, ALUIZNI ka dërguar pranë Bashkisë Tiranë vetëm shkresën për llogaritjen e pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 32,385,690 lekë.**

**Për sa më sipër propozohet:**

**I- Neni 46, pika 1** e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, **ishte:**

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me nenet 2, 4, 15, 17 pika 2, 18, 28, 34 e 45 të këtij ligji”

**Bëhet:**

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me nenet 2, 4, 15, 17 pika 2, 18, **27**, 28, 34 e 45 të këtij ligji”

**II- Pika 5** e VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”,

**Ishte:** “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

*Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”*

**Bëhet:**

*Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.*

Drejtoritë e ALUIZNI-t:

**a- Për zbatimin e kësaj pike, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore të dhënat e ndërtimeve që do të pajisen me leje legalizimi.**

**b- Në momentin e lëshimit të lejes së legalizimit të administrohet në dosjen e objektit informal vërtetimi mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.**

**B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga Auditmi:** Në 1660 raste, Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” – **“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”** si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“ c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar. Në kualifikimin e objekteve informalë, ka dërguar pranë Bashkisë Tiranë vetëm shkresën për llogaritjen e pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 32,385,690 lekë.**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria ALUIZNI-t Tirana 2, për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë Bashkisë Tiranë vërtetimin mbi

Ilogaritjen e likuidimit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për **1660 rastet në vlerën prej 32,385,690 lekë**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer, u konstatua se: Në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 2 është proceduar me daljen nga arshiva i 4367 dosjeve për azhurnim ( kryerjen e matjeve në teren) dhe nuk është vepruar për përfundimin procesin e lejeve të legalizimit, por janë futur përsëri në arshivë pa arsye të dokumentuara. Nga dosjet e trajtuara ka dokumentacion vetëm për 936 prej tyre duke përcaktuar se 301 dosje të azhurnuara nuk plotësonin kushtet për kualifikim pasi janë ndërtime mbi trotuar ose buzë rrugës. Për 301 dosje të azhurnuara, si dhe për 41 njolla në hartë që i përkasin 204 objekteve informale të ndërtuara mbi trotuar, buzë rrugëve etj., që cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim, nuk janë zbatuar procedurat për shkualifikimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pikën 5 të nenit 2 dhe nenin 39-*Përfundimi nga Legalizimi*, Kapitulli IV i VKM nr. 280, datë 01.04.2015, urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 ndryshuar me 954, datë 25.11.2015 .

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2 të marrë masa, për të gjitha objektet informale të cilat nuk plotësojnë kriteret për legalizim, të ndiqen procedurat, për shkualifikimin e tyre nga procesi i legalizimit dhe të njoftohen aplikuesit si dhe Bashkia Tiranë, për tu trajtuar si ndërtime të paligjshme që nuk përfshihen në legalizim.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2 ka nisur në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t 16 shkresat për shpronësimin e 685 parcelave ndërtimore në pronë të të tretëve (Ish Pronarë) në vlerën totale 72,660,714 lekë për shpronësim, deri në momentin e auditimit nuk ka dokumentacion për mbylljen e procesit dhe nxjerrjen e VKM për shpronësim parcelave ndërtimore që i përkasin 115 objekteve në vlerën **22,082,031 lekë** .

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe marrjen e masave që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të mundësohet daljen e VKM për shpronësim të parcelave ndërtimore të **115 objekteve të legalizuara** në një vleftë të parcelave ndërtimore prej **22,082,031 lekë**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Në **29 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi*

- Në **20 raste** në dosjen e Lejes së Legalizimit lëshuar për objektet “Shtesë kati në objektit ekzistues”, mungon akt marrëveshja me banoret e kateve të tjera, si bashkëpronarë të ndodhur vertikalisht, pra nuk ka akt noterial në dosje me banoret, për përdorimin e sipërfaqes së përbashkët;

- Në **9 raste** në Lejen e Legalizimit të lëshuar në kondicionet e veçanta është shënuar sipërfaqe verandë, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 2, me ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” neni 5, “Objekte në pronësi të përbashkët” ku përcaktohet: -“*1.Objekte në pronësi të përbashkët janë të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë. Prona e përbashkët është e pandashme dhe është në pronësinë e përbashkët të pronarëve të njësisive individuale, në përputhje me kuotën e pjesëmarrjes në*

*bashkëpronësi. Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, që nuk janë destinuar për përdorim individual dhe nuk janë pronë publike, si truallin, mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimin, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat.” në përputhje e zbatim edhe me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa”, pika 2 .*

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 2 në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

**5. Gjetje nga auditimi: Në 16 raste** “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” .

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që për 16 rastet e konstatuara të plotësohet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Në rastin e mos plotësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

**6. Gjetje nga auditimi: - Në 7 raste** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2 nuk ka respektuar afatin 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose skualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, veprime këto në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8 “*Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht” .*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që më plane konkrete të shqyrtojë kërkesat për të zbatuar afatet ligjore për shqyrtimin e praktikave të legalizimit në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve,

*procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8”.*

**7. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2 në 13 raste nuk disponohet në dosje dokumentacionin që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje, pjesën e shtesës pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit dhe kohën ndërtimit**, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1, si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje".

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që për 13 rastet e konstatuara me mos dokumentacionin që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje, pjesën e shtesës pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit dhe kohën ndërtimit**, konkretisht: dosja nr. 178, datë 06.09.2006; dosja nr. 5, datë 11.06.2013; dosja nr. 461, datë 04.07.2013; në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

**8. Gjetje:** Në 1 rast për subjektin Z. A. K, Dosja nr. 1288, datë 09.12.2014, ka rezultuar se në llogaritjen e vlerës për pagesën e parcelës ndërtimore është zbritur 10% për pagesën vjetore të energjisë elektrike në vlerë totale 17,947 lekë, por në dosje nuk ka asnjë dokument që vërteton pagesën, për pasojë kjo vlerë duhet arkëtuar nga subjekti në rast se nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve të energjisë elektrike sipas kërkesave të VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që elektrike, përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, pika 11.

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë 2, të marrë masa që për subjektet të cilët përfitojnë zbritje 10% nga shlyerja e detyrimeve vjetore kontraktore të furnizimit me energji elektrike të kërkojë dorëzimin e vërtetimit për pagesën vjetore të energjisë elektrike, në rast të kundërt të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës së zbritur në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, pika 11.

**9. Gjetje:** Në 1 rast për subjektin P.M. K, dosja nr. 300, vetë deklaram pa datë, viti 2006, Leje legalizimi nr. 99795, datë 11.07.2013, për objektin shtesë anësore 2 Kat në objektin ekzistues pallat, ka rezultuar se ndërtimi informal është ngritur mbi truall për të cilin informacioni mbi statusin juridik ardhur nga ZVRPP është i pasaktë pasi zona nuk është futur në sistem dhe nuk garanton gjendjen juridike të pronësisë, si dhe është ndërtuar mbi trotuar dhe në distancë ngjitur me rrugën duke cenuar sistemin rrugor dhe brezat mbrojtës të tyre, për pasojë ky objekt nuk duhet të kualifikohej, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Neni 39 Përjashtime nga legalizimi si dhe VKM Nr. 438, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që

legalizohen ose jo”, pika 2, germa “a”, në fuqi në momentin kur është dhënë leja dhe kualifikuar shtesa informale, aktualisht është në fuqi VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” .

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë 2, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, të marrë masa dhe të rishqyrtojë dhe të vlerësoj Lejen e Legalizimi nr. 99795, datë 11.07.2013, dhënë në kundërshtim me kërkesave e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

**10. Gjetje nga auditimi:** ALUIZNI Tiranë nr. 2(Shtesat) nuk ka administruar dhe mbajtur një evidencë të saktë apo regjistër për shkresat e dërguara në ZVRPP Tiranë në lidhje me statusin e parcelave mbi të cilat janë ngritur ndërtimet pa leje, por shkresat administrohen bashkërisht me shkresat e tjera, si dhe pa caktuar me urdhër të brendshëm një person i cili duhet të mbajë evidencat për marrëdhëniet ALUIZNI-ZVRPP. Mungon informacioni i detajuar para vitit 2014, kjo edhe për shkak të mos marrjes dhe dorëzimit të detyrës me procesverbal nga punonjësit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13, çka ka sjellë si pasojë mungesën e një informacioni të saktë ndër vite për procesin e legalizimit .

**10.1. Rekomandim:** Drejtoria ALUIZNI Tirana 2 të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme për shkresat në lidhje me statutet juridike të pasurive, afatet e trajtimit të tyre, përgjigjet e dhëna nga ZVRPP si dhe problematikat e hasura në vazhdimësi, duke i shërbyer në këtë mënyrë mbarëvajtjes së procesit të legalizimit.

**11. Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Nr. 2, nuk ka administruar dhe mbajtur një regjistër të veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve ndër vite, nuk ka një evidencë të saktë për numrin e ankesave të bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit të tyre si dhe zgjidhjen e problemit. Në disa raste nuk janë respektuar afatet në kthimin e përgjigjeve të ankesave, nuk janë dërguar shkresa drejtuar ZVRPP për marrjen e informacionit për statusin juridik të tyre, si dhe nuk janë respektuar dispozitat ligjore për zgjidhjen e tyre sipas kërkesave të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale i ndryshuar, dhe VKM-ve, urdhrave dhe udhëzimeve të dala në zbatim të këtij ligji, si dhe Ligjit nr. 44/2015 -Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" .

**11.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Nr. 2 të marrë masa, për të krijuar një regjistër të veçantë për administrimin e ankesave, afatet e shqyrtimit të tyre, bazueshmërinë ligjore për zgjidhjen e tyre duke krijuar në këtë mënyrë një praktikë më vete shkresore për çdo ankesë, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale i ndryshuar, dhe VKM-ve, urdhrave dhe udhëzimeve të dala në zbatim të këtij ligji, Ligjit nr. 44/2015-Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga autoriteti kontraktor, Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla ALUIZNI Tiranë Nr. 2 nuk janë krijuar dosje/praktikë e mirëfilltë dokumentare për çdo procedurë prokurimi, dokumentacioni administrohet bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, ndërkohë që pjesa dërrmuese e dokumentacionit që u vunë në dispozicion për auditim, janë të pa

inventarizuara, dhe të pa listuara, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI Tiranë Nr. 2 të marrë masa, të krijojë dosje më vetë për çdo procedurë prokurimi, si dhe të inventarizojë dokumentacionin pjesë përbërëse e praktikës në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

**13. Gjetje:** Në një rast në procedurën e prokurimit me objekt shpenzimi “*Blerje bojëra (tonera)*”, viti 2015, me vlerë 446,600 lekë me TVSh, është shpallur fitues operatori ekonomik “E.... Q”, i renditur në vendin e 10-të në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40- Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël, pika 5, pasi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, pas tërheqjes së 5 operatorëve të parë duhet të anulonte procedurën e prokurimit për të organizuar një të re .

**13.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI Tiranë Nr. 2 të marrë masa që në çdo rast për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të shpallë fitues operator ekonomik të renditur deri në vendin 5 të klasifikimit, në rast të kundërt të anulojë procedurën për të organizuar një të re sipas kërkesave të VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40- Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël, pika 5.

**14- Gjetje:** Në 4 raste në procedurat e prokurimit me blerje të vogla me vlerë totale 473,952 lekë, përkatësisht si vijon: me objekt shpenzimi “*Mirëmbajtje orendi zyre*”, tek subjekti “A... C..” Sh. p. k, në shumën 117,600 lekë me TVSh, “*Mirëmbajtje godine*”, tek subjekti “S.Rr”, në shumën 118,512 lekë me TVSh, “*Rikonstrukcion Rrjeti Informatik*”, tek subjekti “P..C S...”, në shumën 118,800 lekë me TVSh dhe “*Riparime rrjeti Elektrik, Informatik dhe Hidraulik*”, në shumën 119,040 lekë me TVSh, organizimi i procedurave dhe likuidimi i kryer në vlerë **473,952 lekë** me TVSh, janë të pa argumentuara, pasi mungon procesverbali konstatues paraprak për dëmtimet e ndodhura, nuk ka urdhër të titullarit për ngritjen e Komisionit për verifikimin e dëmtimeve të pajisjeve, objektit si dhe nevojën e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes, dokumentuar kjo me procesverbal, nuk është dorëzuar situacioni përfundimtar i shërbimeve që janë kryer, por vetëm preventiv i firmosur nga subjekti dhe jo nga autoriteti kontraktor për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 59 dhe 62, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX , Neni 77- Mbikëqyrja e kontratës, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, pika 47, 52 dhe pika 54.

**14.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI Tiranë Nr. 2 të marrë masa, që për çdo rast procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të shoqërohen me relacion apo procesverbal konstatues paraprak për dëmtimet e ndodhura, të nxirret urdhër i titullarit për ngritjen e Komisionit për verifikimin e dëmtimeve të pajisjeve, objektit si dhe nevojën e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes, dokumentuar kjo me procesverbal, shoqëruar me preventiv dhe situacion përfundimtar të punimeve që janë kryer, firmosur nga subjekti dhe nga autoriteti kontraktor për marrjen në dorëzim të punimeve të kryera.

**15. Gjetje:** Në dy raste në procedurat e prokurimit me objekt “*Shpenzime për blerje mobilje dhe orendi*”, me vlerën 378,000 lekë me TVSh dhe “*Shpenzime për blerje mobilje dhe orendi*”, me vlerë 84,000 lekë me TVSh janë fiktive dhe fituesi është para caktuar, pasi afati i lënë në



dispozicion 2 ditë nga shpallja e fituesit për prodhimin e mobilieve dhe orendive është i pamjaftueshëm referuar natyrë së mallrave dhe pajisjeve që do të prodhohen, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1, pika a, c, d, ç dhe pika dh, Neni 46- Kualifikimi i ofertuesve, pika 3 si dhe VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40- Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël, pika 5 .

**15.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI Tiranë Nr. 2 të marrë masa që në çdo rast për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të vendosë afatet për dorëzimin e mallit në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, me qëllim stimulimin e konkurrencës dhe transparencës në procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1, pika a, c, d, ç dhe pika dh, si dhe Neni 46- Kualifikimi i ofertuesve, pika 3.

**16. Gjetje nga auditimi:** Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, në 3 raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat, ka kërkuar llojin i markës, pa shënimin e detyrueshëm “*ose ekuivalent*” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5 .

**16.1. Rekomandim :** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 2, Njësia e Prokurimit të marrë masa, që për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, kur për një mall të caktuar kërkohet lloji i markës të vendos shënimin e detyrueshëm “*ose ekuivalent*” në përputhje me kërkesat Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

**17. Gjetje:** Nga Drejtoria e ALUIZNI Tiranë Nr. 2, në organizimin procedurave të prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar në përputhje me kërkesat ligjore pasi:

- Në 14 raste në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, me vlerë totale 4,171,883 lekë nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit si dhe dokumentacion justifikues, dhe në 7 raste mungon relacioni apo procesverbali konstatues nga personat kompetent dhe nga Sektori i Financës, për nevojën për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim veprime këto në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40-Prokurim me vlerë të vogël, pika 3, neni 59 dhe UMF, nr. 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” ndryshuar;

- Në 7 raste prokurimet me vlerë të vogël, me vlerë totale 712,332 lekë nuk është ngritur Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Mallit, mungon procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, faturat tatimore apo fletë hyrjet nuk janë të detajuara sipas artikujve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, por vetëm është shënuar sasia totale e mallit dhe vlera përkatëse, në disa raste faturat tatimore nuk janë të firmosura nga të gjithë anëtarët e Grupit të Marrjes në Dorëzim të Mallit, në disa raste dorëzimi i mallit nuk është shoqëruar me fletë garanci, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX , Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, 45, 47, 52 dhe pika 54;

- Në 3 raste në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, me vlerë totale 1,123,940 lekë ka shpallur fitues operatorët ekonomikë edhe kur nuk kanë plotësuar specifikimet e kërkuara në ftesën për ofertë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i

ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 28.02.2014, Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr. 1, datë 21.04.2016;

- Në 4 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime. Mos hartimi i kërkesave nga njësitë apo zyrat përkatëse bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IV, neni 40 si dhe UMF, nr. 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në 2 raste procedurat e prokurimit në sistemin elektronik nuk janë të rregullta pasi nuk janë hedhur njoftimet për skualifikimin dhe shpalljen fitues në rastet kur operatorët e radhës kanë hequr dorë nga konkurrimi, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit Nr. 5, datë 27.01.2015 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”, dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr. 1, datë 21.04.2016 .

**17.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI Tiranë Nr. 2 të marrë masa, që për çdo rast procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të shoqërohen me relacion apo procesverbal për hartimin e fondit limit, procesverbal konstatues nga personat kompetent dhe nga Sektori i Burimeve Njerëzore për dëmtimet e ndodhura, të mbahet procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit dhe shërbimit, i detajuar sipas artikujve dhe specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe dokumentet e tenderit, i firmosur nga të gjitha anëtarët e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Mallit, si dhe të bëhet njoftimi në sistemin e APP-së për skualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik.

**18. Gjetje:** Nga shqyrtimi dhe verifikimi i ankesës së shtetasit A.C, administruar në KLSH me nr. 550 prot, datë 11.05.2016, i cili pretendon se për të njëjtën pronë me numër pasurie 7/104, përveç vetë deklaramit të bërë prej tij pranë Drejtorisë ALUIZNI Tirana Nr. 1(Veri), ekziston dhe një vetë deklarim tjetër i bërë nga shtetasit F.K dhe A.K pranë ALUIZNI Tirana Nr. 2(Shtesat), **rezultoi se:**

**Së pari:** Në dosje administrohet vetë deklarimi firmosur nga shtetasi F.K në datë 30.01.2015, ndërkohë që është protokolluar me nr. 4066 prot, datë 26.01.2015, sipas të cilit deklarohet se ndërtimi pa leje është ngritur në vitin 1993, me adresë Rr. “Dibrës” 213, Njësia Administrative nr. 9, Tiranë. Në dosje administrohet certifikata familjare e cila është lëshuar në datën 30.01.2015, e cila përkon me datën e deklaramit. Gjithashtu nga verifikimi i regjistrat dixhital të deklaramive administruar në ALUIZNI Tirana Nr. 2(Shtesat) dhe i aksesueshëm online në faqen zyrtare të ALUIZNI, rezulton se me numër rendor 4066 është regjistruar vetë deklarimi me nr. 4066 prot, datë 26.01.2015 nga shtetasi F.K. Ky regjistër është përcjellë fizikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI Tiranë me shkresën nr. 935 prot, datë 13.03.2015, me lëndë dërgim dokumentacioni, bashkëlidhur CD me regjistrat për periudhën 17.09.2014-02.02.2015.

Sa sipër rezulton se vetë deklarimi është brenda afati ligjor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 767, datë 10.09.2014 “Për miratimin e formës, mënyrës së plotësisimit dhe administrimit të deklaramit për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, afati i zgjatur më pas deri në datë 31.01.2015 me Udhëzimin nr. 432, datë 26.12.2014, për një ndryshim në Udhëzimin nr. 767, datë 10.09.2014. Me Udhëzimin nr. 969, datë 15.07.2015 është shfuqizuar Udhëzimin nr. 767, datë 10.09.2014, dhe ka ndryshuar afati i deklaramit.

**Së dyti:** Në lidhje me pretendimin për mos kompetencë të pranimit të aplikimit nga ALUIZNI Tirana Nr. 2(Shtesat), sqarohet se shtetasi F.K sipas vetë deklaramit protokolluar me nr. 4066

prot., datë 26.01.2015, ka deklaruar për shtesën anësore në ndërtimin me leje me adresë Rr. "Dibrës" 213, Njësia Administrative nr. 9, Tiranë. Referuar Urdhrin nr. 641, datë 09.05.2016, të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI- t, "Për përcaktimin e kompetencës territoriale, të disa drejtorive të varësisë të ALUIZNI- t", pika 3 citohet: *Drejtoria e ALUIZNI Tirana Nr. 2, ushtron veprimtarinë dhe funksionet për kryerjen e procedurave administrative, për legalizimin e "objekteve me shtesa tej lejes së ndërtimit" dhe të "tejkalimeve", shtesave informale apo ndryshimeve në funksionin e hapësirave" në objekte të ligjshme, në territorin e të gjithave Njësive administrative të qytetit të Tiranës, pra vetë deklarimet për shtesat janë në kompetencë të kësaj Drejtorie.*

**Së treti:** Praktika në fjalë nuk është marrë akoma në proces shqyrtim, pra nga Drejtori e ALUIZNI Tirana 2, nuk janë përpiluar aktet e ndërmjetme si dhe nuk i është drejtuar me shkresë ZVRPP për identifikimin e pasurive mbi të cilën është ndërtuar objekti informal shtesë anësore me qëllim shqyrtimin dhe sqarimin e ankesës në përputhje me afatet ligjore si dhe kërkesat e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale i ndryshuar, dhe VKM-ve, urdhrave dhe udhëzimeve të dala në zbatim të këtij ligji, si dhe Ligjit nr. 44/2015 -Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin Nr. 120/2014 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

**18.1. Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNIT Tiranë duhet të marrë masa dhe të bëjë bashkimin e dy praktikave, dosjes me nr. 4066 prot, datë 26.01.2015 në emër të F. K vetë deklaruar pranë Drejtorisë ALUIZNI Tirana Nr. 2 si dhe dosjes vetë deklaruar nga A. C pranë Drejtorisë ALUIZNI Tirana Nr. 1(Veri), njoftimin e palëve për paraqitjen e dokumentacionit plotësues ligjor, verifikim dhe azhurnimin e objekteve në hartë, evidentimin e gjendjes faktike të objekteve informale, si dhe të përcaktojë nëse vetë deklarimet janë për të njëjtin objekt shoqëruar me vendimin përkatës për përfshirjen ose jo në fushën e zbatimit të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" si dhe kualifikimin ose jo të objektit informal në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje".

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësit autorizues*), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet përfundimtare të nevojshme në kontabilitet me qëllim për shpërblimin e dëmit në 3 raste me vlerë 51,142 lekë, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Sipas projektit të përditësimit hartuar më 30.06.2014 subjekti ndërtues "G..." ka shtesë kati për 5.4 m<sup>2</sup> ndërtim mbi projektin e zbatimit për të cilin nuk janë aplikuar: taksa e ndikimit në infrastrukturë prej për 7,408 lekë (5.4 m<sup>2</sup> x 27,439 lekë/m<sup>2</sup> x 0.5 %); penalitete në kundërshtim me nenin 43 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin,

urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" në vlerë për 41.04 € ( $5.4 \text{ m}^2 \times 380 \text{ €/m}^2 \times 2\%$ ); nuk është aplikuar tarifa e shërbimit prej 4,000 lekë për 2 kate, pasi ndërtimet pa leje janë aplikuar në 3 kate sipas projektit të përditësimit (nga të cilat për 1 kat është paguar me MA datë 07.08.2014), në shumën 8,000 lekë duke vepruar në kundërshtim me kërkesat të nenet 23 dhe 27 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar si dhe me VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 "Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit" e ndryshuar .

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që në zbatim të kërkesave të neneve 23, 27 dhe 43 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, si dhe me VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 "Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit" e ndryshuar të kërkojë në rrugë ligjore nga subjekti "G.." arkëtimin e vlerës **21,149 lekë** e ardhur si pasojë e mos pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për 7,408 lekë si dhe penalitetit për ndërtime mbi lejen e miratuar për 5,741 lekë si dhe tarifë shërbimi për 8,000 lekë.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në dosjen nr. 4459, për legalizimin e "Objekti 2 dhe 3 kat në rrugën "Jordan Misja" në pronë të familjeve L.S e Th.M" me ndërtues "F...", sipas projektit të përditësimit u konstatua se është ndërtuar  $22.2 \text{ m}^2$  me tepër se projekti i zbatimit miratuar me lejen e ndërtimit. Për sipërfaqen prej  $22.2 \text{ m}^2$  nuk janë aplikuar penalitete në kundërshtim me nenin 43 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" në vlerë për **14,258 lekë** ( $22.2 \text{ m}^2 \times 32,113 \text{ lekë/m}^2 \times 2\%$ ).

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që në zbatim të kërkesave të nenit 43 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **14,258 lekë nga subjektit "F..."** e ardhur si pasojë e mos aplikimit penalitetit për ndërtime mbi lejen e miratuar.

**3. Gjetje:** Në 1 rast për subjektin "A-I-C. ", Dosja nr. A-1883, datë 15.09.2006, vetë deklarim datë 12.09.2006, ka rezultuar se sipas lejes për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit sipërfaqja ndërtimore është  $270 \text{ m}^2$  ndërkohë që sipas lejes së legalizimit sipërfaqja ndërtimore rezulton  $274.9 \text{ m}^2$ , pra  $4.9 \text{ m}^2$  më shumë, sipërfaqe e cila nuk është evidentuar për efekt të pagesës së taksave dhe penaliteteve për shtesat anësore dhe në lartësi tej lejes së ndërtimit. Sipërfaqja tepër prej  $4.9 \text{ m}^2$  nuk është evidentuar në katin kuota 0 dhe kuota 3.5, pra në total sipërfaqja e pa evidentuar është  $9.8 \text{ m}^2$  për të cilën subjekti duhet të paguajë penalitetin për shtesat me funksion shërbimi në vlerë **15,735 lekë** ( $9.8 \text{ m}^2 \times 32,113 \text{ lekë} \times 5\%$ ) në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", Neni 43- Penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues, pika 1, nën-pika b) 5 për qind të çmimit minimal fiskal, për çdo  $\text{m}^2$  sipërfaqe që shfrytëzohet për veprimtari sociale-ekonomike .

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë 2, të marri masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 15,735 lekë nga subjekti "A-I-Const...", ardhur nga mos aplikimi i penalitetit për sipërfaqen prej  $9.8 \text{ m}^2$ , tej lejes së ndërtimit.

## D. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet 37,141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, si

dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me shkrim”**, për këta punonjës:

### **Masa “Vërejtje me shkrim” si më poshtë:**

#### **2. I.P.** me detyrë Drejtor, në cilësinë e ish P/Zyrës

*Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:*

-Në 1 rast “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objekteve nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”.

- në 1 rast nuk disponohet në dosje mos dokumentacionin që të pasqyrojë periudhën e ndërtimit pa leje, pjesën e shtesës pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit dhe kohën e ndërtimit, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: - *“Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përftuar nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.”* si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje"

**II.** Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37,141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit Rajonal të ALUIZNI Tirana 2**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me shkrim”** deri në **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, për këta punonjës:

### **Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 8 punonjës si më poshtë:**

#### **1. E. Ç** me detyrë P/Spektori Hartografisë dhe i Çështjeve të Pronësisë

2. **M. A** me Detyrë Specialist
3. **I.Ç** me Detyrë Specialist
4. **E.Rr** me Detyrë Specialist
5. **E.M** me Detyrë Specialist
6. **A.P** me Detyrë Specialist
7. **A.K** me Detyrë Specialist

*-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:*

-Në 16 raste “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”.

- në 7 raste Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2 nuk ka respektuar afatin 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, veprime këto në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8 “Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafiksht”

- në 13 raste nuk disponohet në dosje mos dokumentacionin që të pasqyrojë periudhën e ndërtimit pa leje, pjesën e shtesës pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit dhe kohen ndërtimit, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1, si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje"

- Në 1 rast për subjektin Z.A.K, Dosja nr. 1288, datë 09.12.2014, ka rezultuar se në llogaritjen e vlerës për pagesën e parcelës ndërtimore është zbritur 10% për pagesën vjetore të energjisë elektrike në vlerë totale 17,947 lekë, por në dosje nuk ka asnjë dokument që vërteton pagesën, për pasojë kjo vlerë duhet arkëtuar nga subjekti në rast se nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve të energjisë elektrike sipas kërkesave të VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që elektrike, përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, pika 11.

- Në 1 rast për subjektin “A-I-C”, Dosja nr. A-1883, datë 15.09.2006, vetë deklarim datë 12.09.2006, ka rezultuar se sipas lejes për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit sipërfaqja ndërtimore është 270 m2 ndërkohë që sipas lejes së legalizimit sipërfaqja ndërtimore rezulton 274.9 m2, pra 4.9 m2 më shumë, sipërfaqe e cila nuk është evidentuar për efekt të

pagesës së taksave dhe penalteteve për shtesat anësore dhe në lartësi tej lejes së ndërtimit. Sipërfaqja tepër prej 4.9 m<sup>2</sup> nuk është evidentuar në katin kuota 0 dhe kuota 3.5, pra në total sipërfaqja e pa evidentuar është 9.8 m<sup>2</sup> për të cilën subjekti duhet të paguajë penaltetin për shtesat me funksion shërbimi në vlerë 15,735 lekë (9.8 m<sup>2</sup>\*32,113 lekë\* 5%) në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, Neni 43- Penaltetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues, pika 1, nënpika b) 5 për qind të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe që shfrytëzohet për veprimtari sociale-ekonomike.

- Në 1 rast për subjektin P.M. K, dosja nr. 300, vetë deklaram pa datë, viti 2006, Leje legalizimi nr. 99795, datë 11.07.2013, për objektin shtesë anësore 2 Kat në objektin ekzistues pallat, ka rezultuar se ndërtimi informal është ngritur mbi truall për të cilin informacioni mbi statusin juridik ardhur nga ZVRPP është i pasaktë pasi zona nuk është futur në sistem dhe nuk garanton gjendjen juridike të pronësisë, si dhe është ndërtuar mbi trotuar dhe në distancë ngjitur me rrugën duke cenuar sistemin rrugor dhe brezat mbrojtës të tyre, për pasojë ky objekt nuk duhet të kualifikohej, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Neni 39 Përjashtime nga legalizimi si dhe VKM Nr. 438, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, pika 2, germa “a”, në fuqi në momentin kur është dhënë leja dhe kualifikuar shtesa informale, aktualisht është në fuqi VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

- Në procedurën e prokurimit me objekt shpenzimi “Blerje bojëra (tonera)”, viti 2015, me vlerë 446,600 lekë me TVSh, është shpallur fitues operatori ekonomik “E.Q”, i renditur në vendin e 10-të në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40- Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël, pasi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, pas tërheqjes së 5 operatorëve të parë duhet të anulonte procedurën e prokurimit për të organizuar një të re.

- Në **4 raste** në procedurat e prokurimit me blerje të vogla me vlerë totale 473,952 lekë, përkatësisht si vijon: me objekt shpenzimi “Mirëmbajtje orendi zyre”, tek subjekti “A.Ç” Sh. p. k, në shumën 117,600 lekë me TVSh, “Mirëmbajtje godine”, tek subjekti “S.R”, në shumën 118,512 lekë me TVSh, “Rikonstruksion Rrjeti Informatik”, tek subjekti “P.S”, në shumën 118,800 lekë me TVSh dhe “Riparime rrjeti Elektrik, Informatik dhe Hidraulik”, në shumën 119,040 lekë me TVSh, organizimi i procedurave dhe likuidimi i kryer në vlerë 473,952 lekë me TVSh, janë të pa argumentuara, pasi mungon procesverbali konstatues paraparak për dëmtimet e ndodhura, nuk ka urdhër të titullarit për ngritjen e Komisionit për verifikimin e dëmtimeve të pajisjeve, objektit si dhe nevojën e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes, dokumentuar kjo me procesverbal, nuk është dorëzuar situacioni përfundimtar i shërbimeve që janë kryer, por vetëm preventiv i firmosur nga subjekti dhe jo nga autoriteti kontraktor për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 59 dhe 62, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX, Neni 77- Mbikëqyrja e kontratës, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, pika 47, 52 dhe pika 54.

- Në **dy raste** në procedurat e prokurimit me objekt “Shpenzime për blerje mobilie dhe orendi”, me vlerën 378,000 lekë me TVSh dhe “Shpenzime për blerje mobilie dhe orendi”, me vlerë 84,000 lekë me TVSh janë fiktive dhe fituesi është para caktuar, pasi afati i lënë në dispozicion 2

ditë nga shpallja e fituesit për prodhimin e mobilieve dhe orendive është i pamjaftueshëm referuar natyrë së mallrave dhe pajisjeve që do të prodhohen, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1, pika a, c, d, ç dhe pika dh, Neni 46- Kualifikimi i ofertuesve, pika 3 si dhe VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40- Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël, pika 5.

- Në **14 raste** në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, me vlerë totale 4,171,883 lekë nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit si dhe dokumentacion justifikues, dhe në 7 raste mungon relacioni apo procesverbali konstatues nga personat kompetent dhe nga Sektori i Financës, për nevojën për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim veprime këto në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40-Prokurim me vlerë të vogël, pika 3, neni 59 dhe UMF, nr. 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” ndryshuar;

- Në **7 raste** prokurimet me vlerë të vogël, me vlerë totale 712,332 lekë nuk është ngritur Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Mallit, mungon procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, faturat tatimore apo fletë hyrjet nuk janë të detajuara sipas artikujve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, por vetëm është shënuar sasia totale e mallit dhe vlera përkatëse, në disa raste faturat tatimore nuk janë të firmosura nga të gjithë anëtarët e Grupit të Marrjes në Dorëzim të Mallit, në disa raste dorëzimi i mallit nuk është shoqëruar me fletë garanci, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX , Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, 45, 47, 52 dhe pika 54;

- Në **3 raste** në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, me vlerë totale 1,123,940 lekë ka shpallur fitues operatorët ekonomikë edhe kur nuk kanë plotësuar specifikimet e kërkuara në ftesën për ofertë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 28.02.2014, Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr. 1, datë 21.04.2016;

### **Masa “Vërejtje me shkrim” për 1 punonjës si më poshtë:**

#### **1. S. Xh.** me detyrë Juriste

*Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:*

- ALUIZNI Tirana 2 nuk ka administruar dhe mbajtur një evidencë të saktë apo regjistër për shkresat e dërguara në ZVRPP Tiranë në lidhje me statusin e parcelave mbi të cilat janë ngritur ndërtimet pa leje, por shkresat administrohen bashkërisht me shkresat e tjera, si dhe pa caktuar me urdhër të brendshëm një person i cili duhet të mbajë evidencat për marrëdhëniet ALUIZNI-ZVRPP. Mungon informacioni i detajuar para vitit 2014, kjo edhe për shkak të mos marrjes dhe dorëzimit të detyrës me procesverbal nga punonjësit, në kundërshtim me Udhëzimin e



Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13, çka ka sjellë si pasojë mungesën e një informacioni të saktë ndër vite për procesin e legalizimit.

- Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Nr. 2, nuk ka administruar dhe mbajtur një regjistër të veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve ndër vite, nuk ka një evidencë të saktë për numrin e ankesave të bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit të tyre si dhe zgjidhjen e problemit. Në disa raste nuk janë respektuar afatet në kthimin e përgjigjeve të ankesave, nuk janë dërguar shkresa drejtuar ZVRPP për marrjen e informacionit për statusin juridik të tyre, si dhe nuk janë respektuar dispozitat ligjore për zgjidhjen e tyre sipas kërkesave të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale i ndryshuar, dhe VKM-ve, urdhrave dhe udhëzimeve të dala në zbatim të këtij ligji, si dhe Ligjit nr. 44/2015 -Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

- Nga autoriteti kontraktor, Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla ALUIZNI Tiranë Nr. 2 nuk janë krijuar dosje/praktikë e mirëfilltë dokumentare për çdo procedurë prokurimi, dokumentacioni administrohet bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, ndërkohë që pjesa dërrmuese e dokumentacionit që u vunë në dispozicion për auditim, janë të pa inventarizuara, dhe të pa listuara, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- Në një rast në procedurën e prokurimit me objekt shpenzimi “*Blerje bojëra (tonera)*”, viti 2015, me vlerë 446,600 lekë me TVSh, është shpallur fitues operatori ekonomik “E. Q”, i renditur në vendin e 10-të në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40- Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël, pika 5, pasi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, pas tërheqjes së 5 operatorëve të parë duhet të anulonte procedurën e prokurimit për të organizuar një të re.

- Në dy raste në procedurat e prokurimit me objekt “*Shpenzime për blerje mobilie dhe orendi*”, me vlerën 378,000 lekë me TVSh dhe “*Shpenzime për blerje mobilie dhe orendi*”, me vlerë 84,000 lekë me TVSh janë fiktive dhe fituesi është para caktuar, pasi afati i lënë në dispozicion 2 ditë nga shpallja e fituesit për prodhimin e mobilieve dhe orendive është i pamjaftueshëm referuar natyrë së mallrave dhe pajisjeve që do të prodhohen, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1, pika a, c, d, ç dhe pika dh, Neni 46- Kualifikimi i ofertuesve, pika 3 si dhe VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40- Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël, pika 5.

- Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, në 3 raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat, ka kërkuar llojin i markës, pa shënimin e detyrueshëm “*ose ekuivalent*” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

- Në **2 raste** procedurat e prokurimit në sistemin elektronik nuk janë të rregullta pasi nuk janë hedhur njoftimet për shkualifikimin dhe shpalljen fitues në rastet kur operatorët e radhës kanë hequr dorë nga konkurrimi, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit Nr. 5, datë 27.01.2015 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”, dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr. 1, datë 21.04.2016.

**Për 7 punonjës aktual, nuk propozojmë masë pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirëfunksionimin e institucionit, nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore, si më poshtë:**

**1- znj. T.K,** me detyrë ish- Përgjegjëse e Sektorit të Financës nga data 06.01.2014- 20.10.2014, për shkeljet e trajtuara në procesverbalin nr. 1, datë 15.02.2017, aktualisht specialiste.

**2- znj. A.Q,** me detyrë ish- Përgjegjëse e Sektorit të Financës nga data 20.10.2014- 17.09.2015, për shkeljet e trajtuara në procesverbalin nr. 1, datë 15.02.2017 aktualisht specialiste..

**3- znj. R.G,** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës nga data 17.09.2015- në vazhdim, për shkeljet e trajtuara në procesverbalin nr. 1, datë 15.02.2017.

**5- z. D.P,** me detyrë Specialist Arkiv Protokolli nga data 01.04.2014-në vazhdim, për shkeljet e trajtuara në procesverbalin nr. 1, datë 15.02.2017.

**6- z. G.S,** me detyrë Specialist, për shkeljet e trajtuara në procesverbalin nr. 1, datë 15.02.2017.

**7- z. A.K,** me detyrë Specialist, për shkeljet e trajtuara në procesverbalin nr. 1, datë 15.02.2017.

**Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.**

I. Për **18** ish punonjësit, që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** deri në **“Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”**, përkatësisht për: A.N, E. K, E.M, A.S, E.M, E.K, L. D, D. Z, M. K, G. S, E. Rr, F. H, M. S, A.M, D.M, A.S, G.H, A.M.

**E. INDICIE PËR KALLËZIM PENAL:**

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika “gj” e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 ”Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik rast pas rasti* nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal **për 3 punonjës**, si më poshtë:

- 1. A.S ish P/Sektorit të Hartografisë,**
- 2. E.K ish P/ Sektorit Urbanistikës dhe Legalizimit,**
- 3. A.N ish Drejtori.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**